

Prishtinë: 27 Maj 2009  
Kodi i ZRRE-së: V\_178\_2009

**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, duke u bazuar në:**

1. Nenin 15,26, dhe 31 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë të amendamentuar me Ligjin Nr. 03/L-080;
2. Nenin 37 të Rregullit për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë, dhe
3. Dispozitat e Nenit 37.2 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare, dhe
4. Kërkesën e datës 05.01.2009 për vazhdim të licencës furnizim/tregti me energji elektrike dhe për ushtrimin e aktivitetit të tregtimit me energji elektrike të ndërmarrjes “Grupi i Sistemeve Automatike” sh.p.k (GSA), me adresë Rr.” Dëshmorët e 4 Shkurtit”, Pall.30, P.O. Box 1502, Tiranë, Shqipëri.

**në mbledhjen e mbajtur më 27 Maj 2009 nxori këtë:**

**VENDIM**

- I. **VAZHDOHET edhe për dy (2) vjet** periodha e vlefshmërisë së licencës për furnizim/tregti me energji elektrike Nr. ZRRE\_Li\_24/07 e lëshuar me datë 23.05.2007 ndërmarrjes “Grupi i Sistemeve Automatike” sh.p.k (GSA), Shqipëri.
- II. **Vazhdimi** i licencës do të vlejë nga data 23.05.2009 si datë e skadimit të periudhës fillestare të vlefshmërisë së licencës, e deri më datë 23.05.2011.

**Arsyetim**

1. Zyra e Rregullatorit për Energji me datë 05.01.2009 ka pranuar me anë të postës nga kompania “Grupi i Sistemeve Automatike” sh.p.k (GSA), Shqipëri, kërkesën për vazhdim të licencës për Furnizim/Tregti me energji elektrike me Nr. ZRRE\_Li\_24/07, e datës 23.05.2007 e cila ka skaduar me datë 23.05.2009.
2. ZRRE ka vlerësuar kërkesën e kompanisë “Grupi i Sistemeve Automatike” sh.p.k (GSA) dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
3. ZRRE me rastin e vendosjes për kërkesën në fjalë ka marrë për bazë dispozitat e nenit 37.2 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare që përcaktojnë se tregtarët e huaj nuk kanë nevojë të regjistrohen si shoqëri tregtare në Kosovë nëse energjia elektrike i dorëzohet një blerësi me shumicë në Kosovë.



4. Kjo licencë e vazhduar i lejon të licencuarit që të kryejë vetëm aktivitetin e **tregtisë** së energjisë elektrike në Kosovë.
5. Nëse i licencuari dëshiron të zhvillojë edhe aktivitete të furnizimit me energji elektrike të përcaktuara me nenin 4 të licencës, atëherë i njëjti duhet të përmbushë obligimet tjera që përcaktohen me Ligjin për Shoqëritë Tregtare dhe legjislacionin e aplikueshëm në Kosovë.
6. Ky Vendim nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve , do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
7. Ky Vendim hyn në fuqi datën e miratimit të tij nga Bordit i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij Vendimi palët e pakënaqura mund të iniciojnë procedurë gjyqësore në Gjykatën Kompetente në Prishtinë brenda (14) ditëve nga pranimi i Vendimit ose shpalljes së Vendimit në faqen tonë elektronike, cilado që ndodhë e para.

#### **Bordi i ZRRE-së**

\_\_\_\_\_  
Dr. Ali Hamiti, kryesues

\_\_\_\_\_  
Theranda Beqiri, anëtare

\_\_\_\_\_  
Dr. Nysret Avdiu, anëtar

\_\_\_\_\_  
Përparim Kabashi, anëtar

\_\_\_\_\_  
Blerim Koci, anëtar